



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

## PROCESVERBAL

### Nga mbledhja inauguruese e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 26.12.2013

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën 10:10. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Dibran Përçuku, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Gani Imeri, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Ismet Gashi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Mirjeta Salihu, Mentor Ferizi, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Sami Istrefi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani, Xhevrije Rama dhe Zoran Rakic.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, përfaqësues të Gjykatës Themelore - dega në Vushtrri, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësuesi i MAPL-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Dibran Përçuku – anëtari më i vjetër i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me vota unanime miratoi këtë:

### REND DITE

1. Formimi i Komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit të komunës.
2. Verifikimi i mandateve nga komisioni në fjalë.
3. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të komunës.
4. Dhënia e betimit të kryetarit të komunës.
5. Fjala përshëndetëse e kryetarit të komunës.
6. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të komunës.
7. Fjala përmbyllëse e kryesuesit të zgjedhur të Kuvendit të komunës.



**1. Formimi i Komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit të komunës.**

**Sami Istrefi, anëtar i kuvendit-** propozoi për anëtar të komisionit Nezir Klinakun nga PDK-ja.

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** propozoi për anëtar të komisionit Agim Bregajn nga LDK-ja.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-** propozoi për anëtar të komisionit Sabri Feratin nga AAK-ja.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Formohet Komisioni për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit të komunës, në këtë përbërje:**

**a. Nezir Klinaku (PDK);**

**b. Agim Bregaj (LDK);**

**c. Sabri Ferati (AAK).**

**2. Verifikimi i mandateve nga komisioni në fjalë.**

Komisioni i formuar verifikoi mandatin e të gjithë anëtarëve të rinj të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me ç'rast konstatoi se nuk mungon asnjë anëtar i Kuvendit të komunës.

**3. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të komunës.**

Pas verifikimit të mandateve të anëtarëve të Kuvendit të komunës, anëtarët në fjalë e dhanë betimin dhe e nënshkruan tekstin e betimit.

**4. Dhënia e betimit të kryetarit të komunës.**

Pas dhënies së betimit të anëtarëve të Kuvendit të komunës, e bëri betimin dhe e nënshkroi edhe Kryetari i Komunës së Vushtrrisë.

**5. Fjala përshëndetëse e kryetarit të komunës.**

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** iu uroi anëtarëve të rinj të Kuvendit të komunës mandatin, duke iu dëshiruar shëndet dhe suksese në punën e përbashkët në funksion të interesit të përgjithshëm të komunës dhe mirëqenies të të gjithë qytetarëve të komunës tonë. Juve të nderuar ish-anëtarë të Kuvendit të komunës të mandatit të kaluar, ju falënderoj për angazhimin e juaj të pakursyer dhe bashkëpunimin konstruktiv që treguat me mua, në realizimin e shumë projekteve të rëndësishme për qytetarët e komunës sonë. Pastaj përshëndeti mysafirët e ftuar në mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës dhe shtoi se ndjehet i privilegjuar, por njëkohësisht edhe me shumë përgjegjësi që u rizgjedh me votën e lirë të qytetarëve, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë. Ky besim i dhënë ka peshë të veçantë për mua, sepse qeverinë që e udhëhoqa deri tani dhe subjektit politik të cilit i përkas -PDK-së, është një konfirmim i një pune të suksesshme që kemi bërë për 6 vitet e kaluara. Fakti që në një periudhë 6-vjeçare arritëm të kryejmë një numër të madh të projekteve të rëndësishme vitale, të përmirësimit të jetës së qytetarëve të komunës, më bëjnë që të ndjehem mirë, pas përfundimit të këtij mandati dhe rifillimit të mandatit të ri.

Në vazhdim shpalosi shkurtimisht disa nga të arriturat e rëndësishme të veçantë, që janë realizuar brenda periudhës së kaluar 6-vjeçare.

Ndërkaq në fund shpalosi disa prej objektivave tjera themelore për periudhën 2013 - 2017, të qeverisë komunale të cilën do ta udhëheq.

## 6. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të komunës.

**Dibran Përçuku, anëtar i kuvendit (kryesues i mbledhjes)**- propozoi që të formohet komisioni votues për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të komunës.

**Sami Istrefi, anëtar i kuvendit**- propozoi për anëtar të komisionit Nezir Klinakun nga PDK-ja.

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit**- propozoi për anëtar të komisionit Agim Bregajn nga LDK-ja.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit**- propozoi për anëtar të komisionit Sabri Feratin nga AAK-ja.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

**Formohet Komisioni për votim për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës, në këtë përbërje:**

**a. Nezir Klinaku (PDK);**

**b. Agim Bregaj (LDK);**

**c. Sabri Ferati (AAK).**

Në vazhdim u propozua kandidati për pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

**Sami Istrefi, anëtar i kuvendit**- propozoi Shpëtim Zhegrovën nga PDK-ja për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota "për", 10 "kundër" dhe 2 "të pavlefshme" vendosi me sa vijon:


**Shpëtim Zhegrova - anëtar i KK-së, zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.**

## 7. Fjala përmbyllëse e kryesuesit të zgjedhur të Kuvendit të komunës.


**Shpëtim Zhegrova, kryesues i Kuvendit të komunës**- falënderoi anëtarët e Kuvendit të komunës për besimin e dhënë, duke premtuar se si kryesues i Kuvendit të komunës, punën e vet do ta kryejë në përputhje të plotë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Vushtrrisë dhe Rregulloren e punës së kuvendit, si dhe me ligjet tjera në fuqi, të cilat rregullojnë kompetencat e komunës. Po ashtu premtoi për një punë transparente dhe një bashkëpunim të ngushtë me qeverinë e re lokale dhe me të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës, pa dallime partiake.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Procesmbajtësi:

  
Alban Tahiraj

Kryesuesi i mbledhjes:

  
Dibran Përçuku

Lekturoi:

Vlora Krasniqi